Prerjen e pjerrtësive me terrenin duhet formuar në tërësi sipas detajeve në projekt.

Gërmimet do të bëhen deri te kuota e shiritit të rrugës dhe atë, me ramje të rregullta dhe pjerrtësi të rrafshëta, të cilat përputhen (sinkronizohen) me projektin, gjegjësisht me përcaktimet gjatë punës. Saktësia e gërmimit është ± 4 cm, kurse sasia e gërmuar më tepër në profil, nuk paguhet.

Me këtë pozicion është përfshire edhe planifikimi i pjerrtësive për gërmimin dhe gërmim mbushje përmirësimin eventuale të nevojshëm mbi tolerimin ± 4 cm, në shtrat të rrugës, e pas ngjeshjes së nën-sipërfaqes së dheut të rrugës, kryesi i punëve do ta eviton me shpenzimet e veta .

Pas kryerjes së mihjes, të profilin tërthorë, me saktësi të kërkuar, mund të vazhdohet me punime në pozicionet vijuese.

Çmimi sipas këtij pozicioni përfshinë, kompensimin për gropim, të m^3 dhe të kategorisë së III-IV, V-IV dhe IV-VII, ngarkimin në mjet transportues, bartjen transportuese në largësi të caktuar, të $1 m^3$ dhe të shkrihtë (pa marrë parasysh koeficientin e ngarkimit).

Çmimi njësi përfshinë gërmimin e dheut të kategorisë së III – IV dhe V–VII, të ngarkimin, transportin në largësinë transportuese të caktuar, dhe shkarkimin, pa marrë parasysh mënyrën në të cilën bëhet (me dorë apo me makinë), të matur për $1m^3$ dhe të gërmuar.

- a) Me transportim në largësinë e mesme transportuese20 m'
- b) Me transportim në largësinë e mesme transportuese60 m'
- c) Me transportim në largësinë e mesme transportuese200 m'
- d) Me transportim në largësinë e mesme transportuese300 m'
- e) Me transportim në largësinë e mesme transportuese500 m'
- f) Me transportim në largësinë e mesme transportuese 1000 m'
- g) Me transportim në largësinë e mesme transportuese5000 m'

Çmimi sipas këtij pozicioni përfshinë, kompensimin për gërmim, të m^3 të kategorisë së III-të dhe të IV-të, ngarkimin në mjet transportues, bartjen transportuese në largësi të caktuar, të $1 m^3$ dhe të shkrihtë (pa marrë parasysh koeficientin e ngarkimit).

Punimet me zhavor:

Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit mbushës dhe të zhavorit: 50/150 mm, 0/63 mm dhe 0/31.5 mm. Materiali për tampon duhet t'iu përgjigjet rregullave (dispozitave) zvicerane SNV 40375. Materiali duhet të përbëhet prej grimcave të forta dhe të qëndrueshme, të përziera me rërë, me masë pluhurin e gurit për zhavorët 0/63 mm dhe 0/31.5 mm. Materiale 50/150mm duhet të jetë material me përbërje gurore.

Ashtu që, të fitohet përzi e njëllorshme, e cila iu përgjigjet rregullave (dispozitave) Zvicerane, si në pikëpamje të përbërjes granulometrike, ashtu edhe në pikëpamje të stabilitetit.

Përbërja e zhavorit në shtresën e tamponit dhe të mbushjes duhet të jetë me madhësi të kokrrave vetëm deri në 63 mm për zhavorin 0/63 mm dhe 31.5 mm për zhavorin 0/31.5 mm.

Në qoftë se vend-furnizimi me material rërë dhe zhavor që përdoret për përpunimin e shtresës së tamponit, përmban në madhësi të kokrrave më të madhe se madhësitë që cekem me lartë, atëherë, është e nevojshme që materiali të sitet, gjegjësisht gurët të thyhen.

Para përdorimit të materialit, duhet bërë shqyrtimi laboratorik për përshtatshmërinë (kualitetin) e tij për përdorim. Materiali nuk guxon të përmbajë sasi të madhe të lymit, si dhe as materie tjera të dëmshme.

Mund të përdoren mbetje nga vendi gurthyes, në qoftë se iu përgjigjet rregullave (dispozitave) të përmendura. Përqindja e grimcave të vogla të zhavorit 0/31.5 mm dhe 0/63 mm, prej 0-002 mm të llogaritura në përzierjen e tërë, guxon të jetë më së shumti 6% për kufirin e ulët, gjegjësisht 10% - 12% për kufirin e lartë (maksimumi), kjo për rastin kur përbërja e fraksionit ka madhësi granuluse deri në 80%. Por, në qoftë se, përbërja e fraksionit është me madhësi granuluse 80% - 90%, atëherë kufiri i ulët për grimcat e vogla prej 0,02 mm në raport me përbërjen e tërë, guxon të jetë 6% - 3%, kurse kufiri i lartë 1% - 5%.

Kufiri më i ulët, jep pjesëmarrjen e grimcave të vogla prej 0,02 mm, në lidhjet e materialit, në bazë të arritjeve të deri tashme që mund të tolerohet, e që gjatë kësaj të mos vije deri të dëmtimi i materialeve bazë - për shkak të ndikimit të ngricave dhe kushteve të pavolitshme në pikëpamje të lagështisë së tokës, nivelit të ujit nëntokësorë, klimës etj.

Gjatë shqyrtimit të shtresës së tamponit për ngjeshmërinë e duhur, kërkohet që moduli i tkurrshmërisë M_t duhet të jetë:

- a) Për zhavorin 50/150 mm500 kg/cm²
- b) Për zhavorin 0/63 mm700 kg/cm²
- c) Për zhavorin 0/31.5 mm900 kg/cm²

Vlerën e duhur të modulit M_t , do ta caktoj laborator i gjeomekanik i terenit, në teren, varësisht prej përbërjes granulometrike, formës së kokërrzove, vetive plastike dhe lagështisë së materialit i cili përdoret për ndërtimin e shtresës së tamponit.

Kontrollimi i ngjeshmërisë mund të zgjidhet me ndihmën e peshave të rënda (voluminoze), në ç'rast e njëjta lypset të jetë 95% nga ngjeshmëria laboratorike sipas veprimit Proctor të modifikuar.

Shtresa e tamponit pranohet dhe llogaritet në gjendje të përfunduar ndërtimi.

Paguhet për 1 m³, punë të kryera plotësisht ku përfshihet, furnizimi, bartja, shpërndarja-shtrirja dhe ngjeshja.

Punët e Objekteve

Punimi i Lëshesave Gypore – Lëshesat janë paraparë me diametër: $\Phi 600$, $\Phi 800$ dhe $\Phi 1000$.

Poashtu në pjesën e parë (2+410.00 km) kemi lëshesat ekzistuese të cilat duhet të pastrohen, të riparohen (në rast të demtimit) dhe të behetë vazhdimi (në rast se nuk është rregulluar shkarkimi).

Pas fillimit të hapjes të kanalit për vendosjen e lëshesave fillojmë me vendosjen e gypit të betonit për shkak të mos të vi deri të shembja e kanalit. Në rast se hapja e kanalit në tërë gjatësinë e rrugës e pengon komunikacionin atëherë shkojmë vetëm me deri të gjysmë e rrugës, e vendosim gypin dhe mbyllim kanalit në pjesën e parë dhe e rregullojmë për komunikacion pastaj fillomë me pjesën e dytë të rrugës ngjashëm veprojme si me pjesën e parë të kanalit.

Para se fillojë me shtrirjen e gypit të betonit e rregullojmë ramjen e terenit sipas projektit dhe e bëjmë ngjeshjen e terenit, pastaj e bëjmë shtrirjen e një shtrese zhavorrit 0/31.5 mm me trashësi $t=10$ cm të cilën e ngjeshim. Pas ngjeshjes të zhavorrit fillojmë me vendosjen e gypave. Pas shtrirjes të gypit e bëjmë mbështjelljen e gypit të betonit me beton, pas ngurtësimit të betonit fillojmë me mbushjen me material mbushës në trashësi 20-25 cm duke e bërë ngjeshjen e materialit për ç' do shtresë. Pra trashësia e shtresës së materialit për mbushje duhet të jetë maksimal 25 cm për arsye të ngjeshjes më efektive.

Gypat e dedikuar për lëshesa duhet të jenë nga betoni i armuar. Punëkryesi është i obliguar që të ketë testet e nevojshme para fillimit të realizimit të këtij pozicioni. Atesti duhet të përfshijë: klasën minimale të betonit dhe devijimet minimale të mundshme të gypit. Rregullimi i kokave hyrëse dhe

dalëse te lëshesave te betonit duhet të behet nga betoni i armuar. Kënd dhe forma e lëshesave duhet te përputhet me kanalin për largimin e ujërave.

Gjatë ekzekutimit te kësaj pjese te rrugës me kanal të shikohet profili karakteristik,ku janë te paraqitur te gjitha shtresat ne menyre te detajuar.

Punët e Asfaltit

Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfaltit AB 0/16 mm në rrugë, t=8cm

Kushtet e përgjithshme

Pas kryerjes së bazës së poshtme (shtresa e tamponit), e cila duhet të ketë trashësinë dhe profilin e rregullt të paraparë me projekt, saktësi ± 1 cm, gjë që konstatohet me proces, fillohet kryerja e punëve për shtresën e I-rë bartëse prej materialit të bitumenizuar në një shtresë me trashësi t =8 cm, në gjendje të dendur.

Kryerja e punëve për shtresën e I-rë bartëse do të bëhet prej agregati gur të thyer (grimcuar) ose prej materialit natyror zhavor-rërë 0/25 mm 0/22 mm (varësisht nga trashësia e shtresës), me shtimin e filtrit dhe bituminizimit 40/200 me veprim të nxehtë.

Nga zhavori natyrorë, para përdorimit si material, së pari duhet të mënjanohen gurtë e mëdhenj të agregatit, me anë të vendosjes së shoshës në stabilimentet e vibrusit të makinës së asfaltit, ose me vendosjen e veglës së veçantë të vibruesit.

Fraksioni themelorë	Pjesëmarrja e fraksionit themelorë në përzierje minerale
Filer-i 0/009mm	2 – 11
Rëra 0/08/2 mm	19 – 29
Zhavori mbi 2 mm	60 – 76

Tabela 1. Për përpunimin e shtresës së I-rë bartëse prerja minerale

Vija (linja) e shoshitjes së përmbajtjes minerale duhet të jetë në hapësirën kufitare të paraqitur në tabelen si vijon:

Vrimat katrore të sitës mm	Kalimi nëpër sitë %
0.09	5 – 11

0.25	8 – 17
0.71	13 – 27
2	24 – 40
4	34 – 53
8	50 – 70
11.2	61 – 85
16	85 – 100

Tabela 2. *Vija (linja) e shoshitjes së përmbajtjes minerale*

Kualiteti i materialeve themelore

Kualiteti i bitumenit në tërësi sipas rregullave paraprake të përdorimit (JUS. U. M3 010) Kualiteti i filtrit po ashtu si është paraparë (sipas JUS B. BC. 045).

- Vija (linja) e shoshitjes së materialit zhavor dhe rërë, duhet të jetë në kuadër të madhësisë së mesme të përzierjes se paraparë (JUS. U. E9.020.)
- Forma e granulimit të zhavorit siç është paraparë (sipas JUS.B.B8.048)
- Përbërja granulometrike e grimave të cilat dimensionit më i madh i madhësisë është (1) ndaj dimensionit më të vogël (d) mbi 3:1 guxon të jetë max. 40% nga pesha.
- Përqindja homogjene e kokrrave - granulimit të grimcave (sipas JUS.B.B8.037) më së shumti guxon të jetë 4% nga pesha.
- Sasi të lymit sipas (JUS.B.B8.) guxon të ketë më së shumti 5%
- Pastërtia në pikëpamje të materieve organike sipas (JUS.B.B8.039). Ngjyra e tretjes duhet të jetë më e çeltë se ajo standarde krahasuese.
- Qëndrueshmëria e rërës në rrjetë sipas (JUS.B.B8.040). Humbja e peshës sipas shqyrtimit guxon të jetë më së shumti 10%.
- Hedhja, shtjerja sipas metodës Los Angjelos, guxon të jetë. 45%.
- Caktimi vizual i vëllimit sasior sipas (JUS.U.MB.082)
- Ngjitja-lidhja sipas standardeve DIN
- Ne qoftë se përzierja minerale nuk ka ngjitje – lidhje të mirë, i duhet shtuar bitumen, ose duhet bërë përmirësimin e përzierjes minerale me shtimin e grimcave të gurit gëlqerorë.

Kualiteti i grimcave të gurit të thyer

Në qoftë se grimcat e gurit të hapur vendin-depon për gurthyes, atëherë ai duhet, Organi mbikëqyrës, të ia ekspozoi origjinalin, dhe të i bashkëngjis testet provuese, mbi shqyrtimin e gurit. Testi nuk duhet të jetë më i vjetër se një vit, dhe duhet të posedojë vetitë të pasqyruara në tabele nr. 1.

Ne qoftë se guri i plotëson vetitë më lartë të theksuara,

Duhet bërë grincimin e ati gurit dhe grincimin e agregatit mineral, si dhe të dërgohet në shqyrtimin e vetive tjera.

- Analiza mineralogjike-petrografike.
- Mendimi-konstatimi për përdorim.
- Përbërja granulometrike sipas JUS U.MB.102
- Caktimi vizual i vëllimit sasior
- Hedhja-shtjerja sipas metodës Los Angjelos, guxon të jetë max. 45%
- Gjendja homogjene (përqindja e materialit të grimcuar)sipas (JUS B.B8-037) guxon të jetë më së shumti 6%
- Forma e materialit granulës L:t më e madhe se 3:1,e kryesit max. 40%, ku është L - gjatësia,t = 8 cm trashësia.

Në qoftë se shtresa bartëse vendoset mbi bazën e stabilizuar të bituminizuar ose prej gurit të thyer, e njëjta duhet që të stërpiket me 0.8 kg/m² emulsion të bitumenit.

Verifikimi i kualitetit

Laboratori i terenit për asfalt, do të bëjë kontrollimin e materialeve themelore, dhe ato:

- Shqyrtimin e përmbajtjes granulometrike të filer-it në çdo 50-100 t material të porositur
- Shqyrtimin e thellësisë të depërtimit dhe pikën e zbutjes (PK) të bitumenit në çdo 50-100 ton material të porositur
- Shqyrtimin e kualitetit të përzierjes së asfaltit dhe ngjeshjen e shtresës në çdo 4.000 m² të shtresës së shtruar
- Në qoftë e stabiliteti i ekzemplarit është nën minimumin e kufirit të lejuar 10%
- Në qoftë se rrjedhja është nën minimumin e kufirit të lejuar 5%
- Në qoftë se është moduli i forcimit më i vogël ose më i madhe nga vlerat e kërkuara 5%

- Në qoftë se zbraztirat eventuale janë më të vogla ose më të mëdha se kufijtë e caktuar 5%
- Në qoftë se shtresa bartëse e ndërtuar ka dendshmëri më pak se 95 % nga ekzemplari laboratorik.

Për kualitet të dobët të përbërjes së asfaltit dhe dendshmëris së shtresës bartëse mund të zbritet më së shumti 25 % prej vlerës së kontraktuar për këtë pozicion.

Në qoftë se kualiteti është më i dobët se 25 % nga kualiteti i paraparë pjesa e cila nuk i përmbushë kriteret nuk mund të pranohet dhe e njëjta duhet të largohet dhe pastaj të ndërtohet shtresë e re. Pagesa për punën e kryer kalkulohet për 1 m^2 në trashësi $t = 8 \text{ cm}$.

Përpunimi final i lidhjeve (ngjitjeve)

Finalizimi përpunimi i beton asfaltit duhet të posedon veglat në gjendje të rregullt pune për nxehjen e masës së asfaltit në lidhjet (ngjitjet) tërthore dhe gjatësore. Lidhjet tërthore dhe gjatësore duhet ekzekutuar një mbi një. Lidhjen tërthore duhet ekzekutuar në raport me boshtin (aksin) e rrugëve së komunikacionit, nën këndin prej 30° deri në 45° .

Lidhja gjatësore e beton-asfaltit duhet ekzekutuar ashtu që të përputhet me boshtin (aksin) e rrugëve së projektuar.

Vërtetimi i kualitetit

Në tërësi si gjatë përpunimit të shtresës së epërme të I-rë bartëse, por që vetitë e trupave sipas Marshallit duhet të plotësojnë kushtet e shënuara në tabelën e dhënë.

Vlerësimi i kualitetit

Në tersi sikurse te shtresa lidhëse krahas vërejtjes se shtresa janë ndërtuar nga asfalt betoni , duhet të jetë e kompaktuar mbi 97% nga standardet e kërkuara sipas Marshallit.

Vlerësimi i kualitetit për rrafshimin e asfalt betonit

Rrafshimi i asfalt - betonit të ndërtuar matet me aparate speciale , kurse në raste të veçanta me rrafshuese të gjatë 4 metra.

Pas matjes shmangiet nuk guxojnë të jen më të mëdha se $\pm 4\text{mm}$.

Në qoftë se sipërfaqja e ndërtuar ka një devijim më të madhe se $\pm 4\text{mm}$, atëherë kryesit të punëve do ti zbritet vëllimi i pa realizuar dhe atë si vijon .

- a) për shmangiet prej 4-6 mm 10%
- b) për shmangiet prej 6-10 mm 25%

Pjesët e rrugëve së komunikacionit me sipërfaqe jo të rrafshëta ku devijimi është mbi 10mm nuk mund të të pranohen dhe ase të përmirësohen , por kryesi i punëve është i obliguar që këto pjesë ti përpunoj nëse kriteret teknike këtë e lejojnë.

Për punën e kryer përfundimisht pagesa bëhet për 1 m² sipërfaqe të rrugëve varësisht prej trashësisë së shtresës $t = 8\text{ cm}$.

Muret nga Gabionat

Në kuadër të projekti janë përdorur muret nga gabionat për të siguruar stabilitet të pjerrësisë së skarpateve, në pjesët që është berë e zgjerimi i rrugës ne kategorin e terenit III-IV dhe V-VI.

Muret gabion të përdorura janë nga rrjetat heksagonale me diametër të telit 2.7 mm dhe gjerësi të rrjetës 8x10 cm. Telat duhet të jenë të galvanizuar me Galfan (Zn-5% aliazh Alumini) sipas standardit EN 10244-2. Ndërsa aftësia mbajtëse e telave, respektivisht rrjetës duhet të jetë në pajtueshmëri me EN 10223-3.

Karakteristikat teknike të rrjetës janë prezantuar në tabelën në vijim:

Tipi	Madhësia e rrjetës M (mm)	Toleranca (mm)	Diametri i telit (mm)
8x10	80	-0/+10	2.70

Teli i gabionëve duhet të plotësoj karakteristikat në vijim:

- Aftësia mbajtëse në tërheqje: 350 -550 N/mm², sipas EN10223-3:2013,
- Zgjatja: jo më pak se 8%, sipas EN10223-3:2013,
- Toleranca e telit: në pajtueshmëri me EN10218-2 (Klasë T1) dhe ISO22034-2,

- Trashësia minimale e galvanizimit duhet të jetë në pajtueshmëri me EN10244-2 (klasa A) dhe ISO 7958-2,
- Rezistenca e veshjes duhet të përmbushë kriteret sipas EN ISO 6988,

		Telat e rrjetës	Teli për lidhje të anëve	Teli për lidhje të gabionëve
Diam. rrjetës	ø mm	2.70	3.40	2.20
Toleranca e telit	(±) ø mm	0.06	0.07	0.06
Mvjesha minimale e galvanizimit	g/m ²	245	265	230

Vendosja e gabionëve duhet të bëhet sipas specifikimeve të prodhuesit. Gurët për mbushje të rrjetave duhet të jenë rrethore ose drejtkëndëshe dhe duhet të palohen me kujdes që të kemi faqe me teksturë uniforme. Diametri i gurëve duhet të jetë nga 100-200 mm dhe jo më të mëdhenj se 250 mm ndërsa diametri minimal që mund të përdoret është 50 mm, duke siguruar kështu zbrastësira minimale në murin gabion.

Për të siguruar bashkëpunim në mes të segmenteve të mureve gabion, ato duhet të lidhen njëra me tjetrën në skaje me tela lidhës sipas specifikimeve të prodhuesit.

Dimensionet, madhësia, forma dhe pozita e vendosjes së gabioneve është dhënë në pjesën grafike të projektit.

Një përshkrim për Gabionat

Gabionat janë kosha të prodhuar me rrjeta teli të përdredhura dy-fish, të përgatitura në bazë të Direktivës 89/106/ EEC, e cila ka edhe markën CE në përputhje me ETA-09/0414 dhe që jepet bashkë me Certifikatën e Produktit.

Gabionat mbushen me gurë në zonën e ndërtimit dhe formojnë struktura fleksibël, të depërtueshme dhe monolite sic janë struktura mbajtëse, strukturat për veshjen e kanaleve dhe pritat për kontrollin e erozionit.

Në mënyrë që të forcohet struktura, të gjitha bordaturat e paneleve të rrjetës kanë një tel me diametër më të madh se ai i rrjetës (Tab 3). Dimensionet dhe përmasat e gabionëve me tel celiku të veshur me Galfan janë treguar në Tab. 1.

Rjeta e Telit


Rjeta me tel të perdredhur dyfish e përdorur për prodhimin e Gabionave ka karakteristika mekanike më të mira se karakteristikat e sugjeruara nga standarti 10223-3 (Figura posht tekstit). Rezistenca nominale në tërheqje duhet të jetë në përputhje me tabelën 2; Testet janë kryer në përputhje me EN 15381, Aneksi D.

Teli

Teli i celikut i përdorur për prodhimin e gabionëve është thellësisht i galvanizuar me Galfan, një aliazh Zn-5%Al. Specifikimi-met standarte të rrjetës-tel janë treguar në Tabelën 2.

Të gjitha testet e telit duhet të kryhen para prodhimit të rrjetës:

1. Rezistenca në tërheqje: teli i përdorur për prodhimin e gabionëve duhet të ketë një rezistencë në tërheqje midis vlerave 380-550N/mm², ose më të madhe, në mënyrë që të rritet rezistenca në tërheqje e produktit final, e cila sugjerohet nga EN 10223-3. Tolerancat e telit (Tabela 3) janë në përputhje me EN 10218 (Klasa T1).
2. Zgjatimi: Zgjatimi nuk duhet të jetë më pak se 10%, në përputhje me EN 10223-3. Testet duhet të kryhen me një mostër të paktën 25 cm të gjatë.
3. Veshja me Galfan: sasi të minimale të Galfanit të treguara në Tabelën 3 plotësojnë kërkesat e EN 10244-2 (Tabela 2 dhe Klasa A).
4. Aderenca e veshjes Galfan: bashkimi i veshjes Galfan me telin duhet të jetë i tillë që kur teli të jetë mbështjellë gjashtë herë rreth një aksi i cili ka një diametër sa katër-fishi i diametrit të telit, ai nuk duhet të thërmohet ose të thyhet gjatë ferkimit me dore të lira, kjo në përputhje me EN 10244
5. Testi i përshpejtuar për degradimin e veshjes së jashtme në një kondensim të zakonshëm të lageshtisë që përmban dioksid squfuri (28 cikle) sipas EN ISO 6988 (pa shfaqur shënja të kuqe ndryshku).



D

Toleranca në hapësirën nominale të hapjes së rrjetës 'D' është distanca midis aksit të dy thyerjeve të njëpasnjëshme sipas EN 10223-3.

Rrjeta për Mbrojtjen e Skarpateve me pjerrësi nga rënia e Gurëve

Në kuadër të projekti janë përdorur rrjetat për mbrojtjen e shpativë me pjerrësi nga rënja e gurve, që do të realizohet në zgjerimi i rrugës në kategorinë e terrenit VI-VII.

Keto rrjetat janë nga rrjetat heksagonale me diametër të telit 2.7 mm dhe gjerësi të rrjetës 8x10 cm. Telat duhet të jenë të galvanizuar me Galfan (Zn-5% aliazh Alumini) sipas standardit EN 10244-2. Ndërsa aftësia mbajtëse e telave, respektivisht rrjetës duhet të jetë në pajtueshmëri me EN 10223-3.

Karakteristikat teknike të rrjetës dhe përshkrimet tjera janë të ngjajshme me të gabionave

Vërejtje:

1. Matjet janë realizuar nga kompania "Geo Metri"
2. Shqyrtime gjeomekanike të terenit nuk kanë sjell dhe kategorizimi i terenit është bërë vizualisht
3. Gjatë fazës së projektimit kemi vërejtura se kompania që ka bërë matjet gjeodezike nuk ka arritur të bëjë matje të sakta të skarpateve, kështu që kompania jonë e ka pasur të pamundur të përcaktoj saktë nivelin e gërmimit të skarpateve dhe si rrjedhojë e kësaj edhe niveli gabionave ndryshon dhe duhet të përshtatet gjendjes në teren.

5. Konstruksioni i trupit të rrugës

Për nevojat e hartimit të "Projektit të rrugës së Lakut të Kryqes"

Stacionazhat 0+000 km deri më 7+725.00 km

- Gjerësia e rrugës $B=2 \times 2.75= 5.50\text{m}$,
- Gjatësia e rrugës $L=7+725.00 \text{ km}$,

Duhet të kryhet dimensionimi i trupit të rrugës në harmonizim me rregullat teknike me qëllim të caktimit të ngarkesave ekuivalente në komunikacion për bosht standardë të kamionit prej 82 kN.

Analiza e bërë në pamundësi të vlerësimit real të rritjes së komunikacionit gjatë periodesë ekspluatuese prej 20 viteve ka dhënë një shënim prej 2.190,00 BSE (boshteve standarde ekuivalente).

Sa i përket kushteve klimatike në regjionin në të cilin gjendet trasa e projektuar ndikim kryesor ka klima kontinentale me periudë kohore të ftohët gjatë dimrit dhe të nxehtë gjatë verës. Në bazë të shënimeve meteorologjike temperature mesatare vjetore gjatë dimrit sillet nga -15° – $(+10^{\circ})$ ndërsa verës deri 39° .

Konstruksioni i rrugës është projektuar sipas EU-standardeve, në bazë të ngarkesave të parashikuara dhe ngarkesave të materialit në nën-strukturë.

Janë shfrytëzuar elementet e mëposhtme për llogaritje:

- Perioda projektuese 20 vite.
- Ngarkesat e komunikacionit (brenda ditës)..... 200
- Indeksi i aftësisë vozitëse 2.50
- Aftësia mbajtëse e nënstrukturës 3 – 4%.

Koeficientet e materialeve për ndërtim janë:

- Shtresa mbajtëse e asfaltbeton AB_16..... 1.00
- Shtresa e tamponit 0/31.5 mm 0.50
- Shtresa e tamponit 0/63 mm 0.45
- Material Mbushës 0/150 mm 0.40

Stacionazha 0+000 deri më 2+410.00 km

Është llogaritur struktura mbajtëse:

$$SM_l = (8.0 \times 1.00) + (10 \times 0.5 + 20 \times 0.45) + (30 \times 0.40) = 34.00 \text{ cm}$$

Në bazë të llogarisë së mësipërm është përvetësuar konstruksioni i rrugës në trasën bazë sipas zgjidhjes projektuese për periudhën projektuese 20 vjet:

- Asfalt AB_16 8.00 cm
- Shtresa e tamponit 0/31.5 mm 10.00 cm
- Shtresa e tamponit 0/63 mm 20.00 cm
- Shtresa e materialit mbushës 50/150 mm 30.00 cm

Gjithsej = 68 cm

$SM_{ver} = 68.00 \text{ cm}$

SM_I duhet të jetë me e vogël se ajo e vërtetë SM_{ver}

$SM_I < SM_{ver}$

Stacionazha 2+410.00 km deri më 7+725.00 km

$SM_{II} = (8.0 \times 1.00) + (10 \times 0.5 + 20 \times 0.45) + (45 \times 0.40) = 40.00 \text{ cm}$

- Asfalt AB_16 8.00 cm
- Shtresa e tamponit 0/31.5 mm 10.00 cm
- Shtresa e tamponit 0/63 mm 20.00 cm
- Shtresa e materialit mbushës 50/150 mm 45.00 cm

Gjithsej = 83 cm

Që do të thotë se aftësia mbajtëse e konstruksionit të rrugës për aksin e projektuar për kushtet e përvetësuar të eksploatimit është përmbushur.

Nën-struktura prej materialit vendor ose ndonjë materiali tjetër $CBR > 3\%$.

RAPORTI TEKNIK

Pjesa e përgjithshme

Rruga shtrihet në Komunën e Deqanit.

Trasa e rrugës së projektuar, kalon në trasenë ekzistuese me zgjerime në të dy anët e saj.

Rruga shtrihet në një teren të pjerrët malor, ku pjerrtësia gjatësore nuk i tejkalon normat teknike për këto kategori të rrugëve.

Në këtë rrugë nuk parashihet frekuencë e madhe e qarkullimit të automjeteve për një afat kohorë të shkurtër por në të ardhmen do të rritet prandaj:

Si bazë për projektimin e rrugës është shfrytëzuar:

- a) Rilevimi detal i terrenit dhe
- b) Shënimet grafik-numerike të fituara prej matjeve gjeodezike.

Përgjatë trasës së rrugës është zhvilluar poligoni operativ për rilevim të terrenit, dhe i njëjti shërben edhe për shënimin dhe përcjelljes së punëve gjatë fazës së implementimit të projektit.

Poligoni operativ ka karakter kryesisht relative dhe shërben vetëm për nevoja të rrugës.

Elementet teknike

Rruga sipas ngarkesave të komunikacionit renditet në kategorinë e rrugëve rurale.

Në mënyrë analoge janë përvetësua elementet për këtë rend të rrugës sipas detyrës projektuese.

- Shpejtësia llogaritëse $V = \max 40 \text{ km/h}$
- Gjerësia e rrugës: Aksi I $B = 2 \times 2.75 \text{ m} = 5.50 \text{ m}$,

Përshkrimi i trasës

- a) Zgjidhja horizontale e trasës.

Siç e cekem rruga shtrihet në Komunën e Deqanit, dhe aksi shtrihet në një teren të pjerrët kodrinor.

Gjatë projektimit të trasës së rrugës është ruajtur trupi i vjetër i rrugës me zgjerime në të dy anët e saj. Gjeometria horizontale e rrugës është e drejtë.

Pjerrësia tërthore e rrugës është njëanësore. Pjerrësia tërthore e rrugës është 2.5% deri në 4% në kthesa.

- b) Zgjidhja vertikale e niveletës

Gjatë projektimit të trasës është marrë parasysh që pjerrësia e niveletës të jetë në kufi të lejuar sipas normave teknike, brenda mundësive që është lejuar nga detyra projektuese dhe gjendjes ekzistuese të rrugës. Kthesat vertikale të niveletës ju kanë përshtatë kushteve të terrenit.


Ramja më e vogël e niveletës është 0.10 % kurse ramja më e madhe është 15.00 %.

- c) Profilet tërthorë


Profilët tërthorë janë përpunuar në mënyrë detale në shkallë të zvogëlimit 1:100 me të gjitha elementet e nevojshme që janë pjesë përbërëse e projektit. Si pjesë e veçanet e këtij projekti janë dhënë profilët karakteristikë të detajuar në përpjesë 1:50.

Pjerrësitë e mbushjes dhe gërmimit janë caktuar sipas kategorisë së tokës: për mbushje 1:1.5 dhe 1:1 për gërmim të kategoria e III – IV.


Profilë karakteristik
P1-P41, P47-P55, P61-P133, P150-P153, P164-P170, P284-P286, P291-P293, P326-P327,
P350, P362, P392, P415-P416, P452-P476, P500-P532,






Profilë karakteristik
P42-P46, P537-P542



Profilë karakteristik
P177





d) Objektet në trase dhe largimi i ujerave

Largimi i ujerave atmosferike nga trupi i rrugës, është zgjidhë me anë të pjerrësisë tërthore prej 2.5% - 4%, pjerrtësive gjatësore të rrugës duke kaluar në kanale anësore dhe rigolla. Konstruksioni i trupit të rrugës

Për stacionazhat 0+000 deri më 2+410.00 km, konstruksioni i rrugës është llogaritur dhe përbëhet prej:

- Shtresa mbajtëse e Asfaltbeton AB_16..... 8.00 cm
 - Shtresa e tamponit 0/31.5 mm 10.00 cm
 - Shtresa e tamponit 0/63 mm 20.00 cm
 - Shtresa e materialit mbushës 0/150 mm 30.00 cm
- Gjithsej = 68.00 cm**


Për stacionazhat 2+410.00 deri më 7+725.00 km, konstruksioni i rrugës është llogaritur dhe përbëhet prej:

- Shtresa mbajtëse e Asfaltbeton AB_16..... 8.00 cm
 - Shtresa e tamponit 0/31.5 mm 10.00 cm
 - Shtresa e tamponit 0/63 mm 20.00 cm
 - Shtresa e materialit mbushës 0/150 mm 45.00 cm
- Gjithsej = 83.00 cm**


Muret mbajtëse




Gjatë gjithë gjatësisë së rrugës, bazuar në vlerësimin gjeologjik të terrenit, ku shihet e nevojshme, ne kemi përdorur mure guri mbajtës, muret e betonit dhe mbajtja e mureve gjeocel. Këto struktura përdoren për mbrojtjen e rrugës nga rrëshqitjet e tokës dhe shkëmbinjtë që bien në rrugë. Shumica e seksioneve të projektit janë ndërtuar mbi një gjysmë kreshtë me anën e majtë duke qenë një seksion i prerë dhe ana e djathtë është një seksion i mbushur. Ka pjesë me mure mbajtëse deri në 1.5m lartësi deri në 5m. These retaining walls are designed to be stone walls with a varying height of 1.5m to 4.5m, especially necessary where the existing walls have lost their function. Some of the typical sections of these structures that will be used in the realization of this project.


Profil karakteristik
P56-P60, P134-P145, P154-P163, P171-P176, P184-P185,
P431-P434, P447




Profil karakteristik
P146-P149, P196-P245, P252-P266, P280-P283, P280-P283, P294-P325,
P328-P349, P351-P361, P363-P391, P393-P399, P417-P419, P445-P448









Sipërfaqja tipike e mureve mbajtëse

Muret gabion

Në zona të veçanta parashikohet realizimi i mureve gabion. Ka shumë përdorime për këto njësi modulare dhe përdoren zakonisht për të formuar struktura fleksibël, të depërtueshme dhe monolitike, si muret mbajtëse, shtresat e kanalit, strukturat e kontrollit hidraulik dhe mbrojtjen e erozionit. Ata gjithnjë e më shumë po përdoren në aplikimet arkitektonike. Në pjesë të veçanta të segmenteve, ne do të propozojmë për ndalimin e shkëmbinjve të bien pengesat e rënies së shkëmbinjve. Funkcioni kryesor i mbrojtjes së rënies së shkëmbinjve është parandalimi dhe kontrolli i shkëmbinjve dhe mbeturinave nga rënia. Barrierat e shkëmbinjve të bien (ose gardhet e kapur) janë të dizajnuara për të arrestuar / kapur gurët dhe gurët në rënie para se të bien mbi infrastrukturën.



Rrjeta e çelikut është një strukturë lartë çeliku gjeokomponenti kombinuar shkathtësi dhe përfitimet praktike të rrjetë të dyfishtë kthese me ngurtësi të jashtëzakonshme dhe qëndrueshmëri mekanike të kabllave të çelikut të lartë elastik. Kabllot e çelikut janë të endura në mënyrë të integruar në rrjetë të dyfishtë gjatë prodhimit, duke formuar një njësi të vetme, të lehtë për t'u instaluar.

Strukturat e propozuara të kullimit

Strukturat e propozuara janë parashikuar sipas pellgut të shkarkimit të projektit dhe jo sipas kapacitetit të rrjedhjes ose funksionimit të strukturave ekzistuese. Shkarkimi i pellgut ujëmbledhës është shpërndarë në mënyrë të barabartë midis kapaciteteve të vetme të strukturave të parashikuara. Sidoqoftë, meqenëse shpërndarja është jo uniforme, është marrë parasysh një diferencë adekuate sigurie midis shkarkimeve të shkarkimeve të strukturave dhe kapacitetit të rrjedhjes. Për më tepër, strukturat ekzistuese që paraqesin boshllëqe substanciale janë zëvendësuar me struktura me kapacitet të rrjedhjes më të lartë se sa kërkohet teorikisht. Pellgjet e ujitjes ku janë parashikuar strukturat kryesore janë projektuar për të lejuar kalimin e plotë të shkarkimit të pellgut. Kapaciteti i rrjedhës është llogaritur duke zbatuar ekuacionin e bilancit të energjisë dhe duke marrë parasysh lartësinë maksimale lart për një operacion të kontrollit të hyrjes. Diametri minimal i kanalizimit të tubit të propozuar është 1000 mm, diametri minimal i lejuar për kryerjen e punëve të mirëmbajtjes.

6. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis

6.1 Ndikimi në Ajër

Gjatë procesit të ndërtimit të rruges, ndikimi negativ në mjedis shprehet edhe në ajër. Deri te ndotja vie për shkak të punëve dhe aktivitetit në germim, ngarkimit dhe transportit. Ndotësit janë kryesisht pluhuri që barten me anë të erës. Por duke iu falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terrenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrinë deri te vendbanimet e banuara, pasi ato janë larg nga lokaliteti ku ndertohet rruga e asfaltuar. Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimt të gazrave nga përdorimi i përbërësve për lybrifikim të automjeteve të ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës.

6.2 Ndikimet në tokë

Ndikim negativ mund të kenë mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes së makinerisë dhe mjeteve të transportit si dhe mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike që shkaktohen nga vet njeriu.

Ndikim të madh negativ mund të kenë edhe derdhja e vajrave lybrifikues të cilat nëse bien në tokë janë të dëmshme për natyrën pasi që edhe koha e dekompozimit të tyre është e madhe. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshme si dhe nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre.

6.3 Ndikimet në Ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura më lartë të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore, të reshurat atmosferike si dhe nga ndotja e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.

6.4 Ndikimi në Peisazh

Lokaliteti ku planifikohet të ndertohet rruga, ka marrë dhe do të merr pamjen e një vendi industrial.

Gjatë fazës së ndertimit, peizazhi do të pëson degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim, këtij lokaliteti do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të rrethinës. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit të pasurive - resurseve natyrore

6.5 Ndikimi në florë dhe faunë

Gjatë fazës së përgatitjes për ndertim në këtë lokalitet që do të zhvillohen, për pasojë do të kemi dëmtimin e florës, por e cila duhet të rikultivohet pas ndertimit të rrugës. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga rajoni i veprimtarisë eksploatuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

6.6 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të lokalitetit ku do të kryhet ndertimi – asfaltimi i rrugës nuk ka ndonjë objekt banimi prandaj në këtë lokalitet nuk do të ketë zhvendosje të popullatës.

Operatori për ndërtimin me asfalt i rrugës “ **LAKU I KRYQES** , L= 7+725.00 km, K. Deqan në këtë lokalitet do të ketë nevojë për fuqi punëtore shtesë, prandaj do të jetë i detyruar që numrin e punëtorëve ta plotësojë nga popullata vendëse.

6.7 Zhurma

Zhurma e shkaktuar gjatë operacionit të eksploatimit është e karakterit lokal dhe nuk mund të ketë ndonjë ndikim në zonat e banuara.

Zhurma shkaktohet gjatë kryerjes së aktiviteteve eksploatuese, nga makinat që e ngarkojnë lëndën, kamionët transportues etj.

Shfrytëzimi i pajimeve bashkohore për kryerjen e punëve operacionale mundëson që zhurma në hapsirën ku kryhet eksploatimi nuk do të jetë më e madhe se 90dB (duke patur parasysh distancën e lokaliteteve të banuara rreth 3 km). Sa më e madhe të jetë distanca edhe zhurma do të jetë më e vogël.

Do ta japim në formë tabelare nivelin e zhurmës në raport me distancën

Zhurma	Distanca(m)			
	10	50	100	500
90dB - niveli Për paisje moderne	59	45	39	25

6.8 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aktiviteti i ndërtimit me asfalt të rrugës “ LAKU I KRYQES , L= 7+725.00 km, K. Deqan do të jetë i mirëmbajtur si dhe nën mbikqyerjen e stafit profesional që punon në kuadër të kësaj kompanie. Pasi në lokalitetin ku ndërtohet me asfalt i rruga, nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, atëherë rreziqet e mundshme që mund të ndodhin në vend pune mund të jenë të natyrës së ndryshme gjatë procesit të ndërtimit .

7. Ndërmarrja e masave parandaluese në zvogëlimin e ndikimeve

7.1 Masat e ndërmarra për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në ajër të krijuar gjatë realizimit të punëve profesionale, nga mekanizmi për bartjen e lëndës, ngarkimit etj duhet të ndërmerren këto masa:

- ❖ Duhet që në të gjitha pikat kyqe dhe me rrezik të vendosen aparatet kundër zjarrit.

- ❖ Duhet të bëhet spërkatja me ujë e të gjitha sipërfaqeve operacionale , rrugëve të pa asfaltuara nëpër të cilat bëhet edhe transporti i lëndës së prodhuar.
- ❖ Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i pajisjeve teknologjike në mënyrë që gazrat që lirohen nga këto makina të jenë sa më pak të ndotura.
- ❖ Kamionët e transportit të lëndës duhet të mbulohen gjat transportit të lëndës.
- ❖ Kompania duhet që çdo herë ta ketë cisternën e mbushur me ujë dhe të gatshme për punë.

7.2 Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve në tokë gjat kryerjes së punëve operacionale, në kompani duhet të ndërmerren këto masa:

- ❖ Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuara që të mos lejohet kalbja e tyre në mënyrë që ato të mund të përdoren më vonë..
- ❖ Për ti parandaluar pasojat e erozionit duhet të bëjmë rikultivimin biologjik në ato pjesë ku është e mundur.
- ❖ Duhet ndërmarrë masa që vajrat e makinave dhe të pajimeve tjera të mos derdhen në tokë.
- ❖ Nëse për shkak të ndonjë avarie në fazën e prodhimit duhet bërë largimi i vajit nga ndonjë makinë, atëherë duhet patur kujdes që vaji të derdhet në ndonjë enë jo ujëlëshuese e cila duhet të vendoset nën makinën e cila riparohet.
- ❖ Të gjitha mbeturinat e ngurta që krijohen në lokalitet gjatë procesit të prodhimit duhet të grumbullohen dhe të klasifikohen sipas llojit: si p.sh. ato metalike të grumbullohen në vende të posaçme e më pastaj ti shiten kompanive të licencuara për ripërpunimin e tyre kurse ato që mbeten për nevojat e Kompanisë të vendosen nëpër kontejner të veçantë në mënyrë që të mos jenë shkaktar të ndotjes së ambientit.
- ❖ Mbeturinat e lëngëta që krijohen me rastin e ndërrimit të vajrave nëpër makina duhet të vendosen nëpër kontejner të veçantë e më pas tu jepen kompanive të licencuara të cilat merren me riciklimin e tyre

7.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e ujit

Mbrojtja e lokalitetit ku ndërtohet me asfalt i rruga “ LAKU I KRYQES , L= 7+725.00 km, K. Deqan, nga të reshurat atmosferike,

Prandaj për pastrimin e ujërave gjatë eksploatimit duhet të krijohen kanale për bartjen e ujërave të cilët do të shërbenin për largimin e tyre. Duhet patur kujdes që kanalet për largimin e ujërave të pastrohen rregullisht, poashtu duhet të ketë rregullisht absorbues të vajrave motorike dhe karburanteve.

Ujërat e zeza duhet sëpari të trajtohen në gropën septike ku bëhet neutralizimi ndotësve. Gropa duhet të ndërtohet në raport me numrin e punëtorve që punojnë në kompani. Ajo kohë pas kohe pastrohet nga kompani të licencuara për të ikur tejmbushjes.

7.4. Masat e ndërmarra për mbrojtje nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet të krahasojnë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku punojnë dhe jetojnë njerëzit.

Në rast se zhurma e mesit ku punohet i tejkalon kufijt normal atëherë duhet të merren të gjitha masat e duhura që niveli i zhurmës të bie në kufijt normal sipas rregullave në fuqi. Të punësuarit në kompani, varësisht nga vendi i punës duhet të përdorin edhe mjetet mbrojtëse nga zhurma.

7.5 Masat e marrura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore

Masat e mbrojtjes së botës bimore lidhen ngusht me ruajtjen e tokave në pjesët e ngastrave të shfrytëzueshme, këto toka duhet të ruhen nga erozioni i mundshëm.

Kompania duhet që të ketë kujdes gjatë deponimit të mbeturinave që ato të deponohen në vende të caktuara.

Në rast të lajmërimit të zjarrit duhet të merren masa për neutralizimin e tij, kurse paisjet kundër zjarrit duhet të kontrollohen rregullisht dhe të ruhen në mënyrë të veçantë.

Kurse sa i përket botës bimore kompania duhet patur kujdes që ti kufizojë lëvizjet e puntorve sa të jetë e mundur jashta kufinjëve fushës operationale, poashtu të kontrollojë zhurmën e shkaktuar si dhe ti kushtojë kujdes ndotjes së ajrit.

7.6 Mast e marrura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për evitim të rreziqeve nga aksidentet gjatë ndërtimit me asfalt të rrugës “**LAKU I KRYQES**”, L= 7+725.00 km, K. Deçan duhet:

- ❖ Duhet të bëhet plani i intervenimit në raste të aksidenteve ekologjike.
- ❖ Duhet patur kemikate që neutralizojnë derivatet dhe vajrat lybrifikues.
- ❖ Duhet të bëhet plani i mbrojtjes nga zjarri.
- ❖ Duhet që lokaliteti – kantieri i ndërtimit të jetë i thurur.
- ❖ Të merren të gjitha masat e sigurisë në përputhje me ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punëtorëve dhe mjedisit në punë.

8. Programi i monitorimit

Për monitorimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proqeseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë të cilat do të ishin minimale pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve.

Për këtë arsye parashihet një program monitorues për ndërtimin me asfalt të rrugës, K. DEQAN. Monitorimi i ajrit, ujit dhe zhurmës duhet të bëhet me marrjen mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë sipas kërkesës së tyre.

9. Raportimi

Do të kryhet nga udhëheqja dhe ekspertët e Kompanisë së bashku në fund të ndërtimit të rrugës, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen te autoritetet përkatëse në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe komunitetin lokal të komunës.

10. Ndërmarrja e masave rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve prodhuese

Objektivat e rikultivimit

Rikultivimi i brigjeve të rrugës ku është ndërtuar rruga duhet të trajtohet në përputhje me kërkesat bashkohore të mbrojtjes dhe rikultivimit të mjedisit, të cilin duhet pa si një prioritet të rëndësishëm.. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshinë revitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga punimet në rrugë.

Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit - i cili ndikon që pas përfundimit të punimeve operacionale, sipërfaqeve të degraduara prapë të kthehet funksioni i tyre primar (prodhimi i biomasës) dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtijë projekti në ekosistem.

Rikultivimi është i lidhur me aktivitetet ndërtuese, përkatësisht përfundimin e punëve.

Të gjitha aktivitetet e lartëshënuara synojnë objektivat e rikultivimit që kanë këto qëllime:





- ❖ Prodhimin e biomasës
- ❖ Rehabilitimin e peisazhit dhe kthimin e pamjes vizuele në harmoni me formën rellefore të terrenit.
- ❖ Kthimin e profilin pedologjik të tokës së degraduar me rastin e punimeve operacionale.
- ❖ Zgjerimi i kapacitetit filtrues natyror të ajrit.
- ❖ Mvëshja i sipërfaqeve gjvëshura si pasojë e punimeve operacionale.
- ❖ Krijimin e një pejsazhi të bukur, të përafërt me atë të natyrës për rreth.

10.1 Struktura përfundimtare e sipërfaqeve

Struktura përfundimtare e sipërfaqes për rikultivim është e paraqitur në planin e rikultivimit. Pas përfundimit të punimeve operacionale, me rikultivim teknik do të krijohet një profil i ri i tokës bujqësore i cili mundë të përdoret edhe për nevoja tjera . Propozohet që rikultivimi të bëhet me mjelljen e drunjeve të ndryshme dekorative. Për të qenë rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit. Rikultivimi teknik, Rikultivimi agroteknik dhe rikultivimi biologjik.

11. Rikultivimi Biologjik

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siqë janë : Toka, flora e fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësorë, blegtorale etj. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Drunjet dekorativ të cilat i kemi propozuar në këtë projekt, duhet tu përshtaten kushteve klimatike dhe se me zhvillimin e tyre i japin një pamje të bukur peisazhit. Edhe pse janë propozuar këto drunjë, duhet të bëhet konsultimi me ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe me autoritetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë. Përgatitja dhe mbjellja e fidaneve shifet në fig. e më poshtme.



12. Monitorimi pas shfrytëzimit

Pas përfundimit të punimeve, pushon edhe elementi i pluhurit dhe i ndikimeve tjera në mjedis. Prandaj nuk paraqitet nevoja për monitorimin e këtyre ndikimeve.

Por kompania "Arfa" sh.p.k, K. Deqan ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rikultivuar. Duhet cekur se këto hapsira shëndrrohen në toka të pyllzuara.

13. Konkluzion

Ndertimi i rruges në këtë bazë nuk e tejkalon nivelin e vlerave të rekomanduara nga ligji për mbrojtjen në mjedis, ligjet dhe aktet tjera nënligjore për mjedis.

Ndikimet në tokë, ujë, ajër duhet që rregullisht të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohen në fund të punimeve.

Pas punimit të këtijë raporti, mundë të konkludohet se në këtë lokacion nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër, peisazh dhe pamje vizuele. Pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport konstatohet se mundë të minimizohet në nivel të lakmueshëm, ose edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hasirave të degraduara. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhënien e mendimit për pëlqimin Mjedisorë sipas kërkesës së z. Bashkim Ramosaj Kryetari i Komunes së Deqanit .

